



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2022
Nr. Dok. 202200696/2

Lënda : *Rekomandim për inspektimin e kryer në Qendrën Provizore të Pritjes së migrantëve të parregullt në Grehot e Kakavijë, në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin (DVKM), Gjirokastër.*

Drejtuar : **Drejtues Saimir BOSHNJAKU**
Drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
TIRANË

Kryekomisar Sokol CANA
Drejtor i DRKM-së në Gjirokastër

GJIROKASTËR

Për dijeni: **Drejtues Madhor Muhamet Rrumbullaku**
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Qëndrat Provizore të pritjes dhe akomodimit të migrantëve të parregullt në Kakavijë dhe Grehot, në varësi të Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, Gjirokastër.

Inspektimi u krye në datë 09.05.2022, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit përbëhej nga z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi, znj.Gloria Çarkaxhiu dhe z.Hazbi Selita, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve infrastrukturore në Qendrat Provizore të pritjes së migrantëve të parregullt në Grehot dhe në Grupin Operacional Special (GOS) Kakavijë, në varësi të Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, Gjirokastrë, si dhe respektimi i të drejtave dhe trajtimi i migrantëve sipas dispozitave ligjore të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, për këtë qëllim. Gjithashtu objekt i inspektimit ishte dhe verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit, për inspektimin e kryer në vitin 2021¹.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve nga inspektimi i mëparshëm, sipas informacionit të dhënë nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në DPSH, me shkresën nr.276 prot., datë 20.01.2022 rezulton se:

- ✓ Në zbatim të detyrimeve ligjore, është miratuar VKM nr.858, dt.29.12.2021 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e shtetasve të huaj në RSH, ndryshuar me VKM 246, dt.20.04.2022, si dhe VKM nr.857, dt.29.12.2021 “Për ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar për të Huajt”.
- ✓ Gjatë vitit 2022 në matricën e trajnimeve është parashikuar trajnimi i strukturave të policisë kufitare dhe migracionit lidhur me njohjen e legjislacionit të ri për të huajt si dhe me aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij. Trajnimi nuk prek vetëm sferën e njohjes të legjislacionit të ri, por ai fokusohet në mënyrë të vazhdueshme lidhur me zbatimin rigoroz të procedurave të intervistimit apo përzgjedhjes së shtetasve të huaj si në kufi ashtu dhe në territor, kryesisht me personel që rekrutohet rishtas në policinë kufitare dhe migracionit.

¹ Shkresnr.K4/I52-2 prot., datë 06.12.2021 dërgohet “Rekomandime për inspektimin e kryer në DRKM Gjirokastrë.

- ✓ Në lidhje me sigurimin në mjediset e intervistimit të përkthyesve, kryesisht për gjuhët e veçanta Dari, Fars, etj., jemi informuar se, ky problem është zgjidhur me mbështetjen e përkthyesve të angazhuar nga FRONTEX dhe përkthimeve “on line” (vidiocall) të ofruara nga IOM apo UNHCR. Policia Kufitare dhe Migracionit do të përpiqet për ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm të përkthyesve duke përfituar dhe nga programe me vokacion rajonal (kryesisht nëpërmjet MARRI Regional Remote Interpretation Service (RRIS)).
- ✓ Sa i përket kthimit të imigrantëve të parregullt në Greqi, informojmë se procedurat bazohen në marrëveshjen ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar. Deri tani **nuk** është arritur të nënshkruhet një protokoll dypalësh ripranimi me Greqinë me gjithë kërkesat e vazhdueshme të palës shqiptare. Theksojmë se në zbatim të dispozitave të marrëveshjes së sipërcituar, ripranimi i shtetasve të vendeve të treat me qëndrim të parregullt në RSH bëhet mbi bazën e kërkesës për ripranim, shoqëruar me prova/dokumenta të lëshuara nga pala greke.
- ✓ Për krijimin e kushteve të udhëtimit të migrantëve të parregullt që kapen në territorin shqiptarë, janë venë në dispozicion të SPK Kakavijë dy automjete të llojit furgon me kapacitet 8 persona, donacione të IOM, me qëllim transportin e tyre në destinacionet përkatëse në Qendrën e Mbyllur për të huajt në Kareç (Durrës) apo në Qendrën Kombëtare të Azilkërkuesve në Babrru, Tiranë, në varësi të kategorizimit të tyre pas procesit të përzgjedhjes.
- ✓ Për mbulimin me staf ndihmës për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes, pastrimit dhe dizifektimeve periodike të GOS Kakavijë dhe Qendrës së përkohshme të migrantëve Grehot, ende **nuk** është siguruar personel shtesë në varësi të policisë kufitare dhe migracionit Gjirokastër, por kujdesi dhe mirëmbajtja nuk ka munguar asnjëherë në sajë të bashkëpunimit dhe mbështetjes nga Caritas Albania.
- ✓ Për ndërtimin e tendave mbrojtëse në mjediset e jashtme në Qendrën e Grehotit, kryesisht për stinën e verës për të lehtësuar qëndrimin e migraanteve, me ndihmën e donatorëve të ndryshëm biznese etj, brenda 6

mujorit të parë të vitit 2022 do të mundësohet ndërtimi i 1 apo 2 tendave të vogla me stola druri.

- ✓ Në bashkëpunim me Bashkinë Gjirokastrë, është zgjidhur plotësisht problemi i pastrimit të mbetjeve në GOS Kakavijë dhe Qendrën provizore të pritjes së migrantëve në Grehot.
- ✓ **Nuk është zbatuar rekomandimi**, për masat e marra në drejtim të përmirësimit të kushteve infrastrukturore në GOS Kakavijë, pasi godina ka çarje tektonike, ashtu edhe ndriçimin e tunelit që përshkon rrugën nga pika kufitare tek GOS Kakavijë, krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për ngrohje/ftohje brenda ambienteve të brendshme të kësaj qëndre, si dhe për përmirësimin e segmentit rrugor nga pika doganore për në ambientin e GOS Kakavijë.
- ✓ Në kuadër të situatës për parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19, me qëllim ruatjen e sigurisë së jetës dhe shëndetit të të huajve të parregullt dhe personelit të policisë kufitare, institucioni ynë ka rekomanduar marrjen e masave për kryerjen e testeve të shpejta PCR të migrantëve të parregullt. Por, nga informacioni u evidentua se, ende **nuk** kryhen analizat për çdo migrant të parregullt testet e mësipërme, por nëse vetëm ka dyshime dhe vlerësohet domosdoshmëria e kryerjes së testeve për Covid nga vetë migranti apo nga punonjësi i shëndetësisë i kontaktuar nga IOM. Migranti pas diagnostikimit, transportohet menjëherë nga policia kufitare me masat mbrojtëse të nevojshme, për në spitalin e qytetit të Gjirokastrës.

Në Shqipëri hyrja migratore ka ardhur në rritje vit pas viti, pasi nga ana e tyre, vendi ynë konsiderohet një vend tranzit për të vazhduar më tej drejt vendeve të BE-së. Grupet migratore, pasi mbërrijnë në Greqi në mënyra të ndryshme, në rrugë detare ose tokësore, ata më tej hyjnë në Shqipëri. Këtu një pjesë shumë e vogël e tyre kërkojnë azil, ndërsa pjesa tjetër përmes pikave kufitare tokësore në veri të vendit vazhdojnë rrugëtimin drejt Kosovës apo Malit të Zi, me synimin për të shkuar në vendet e BE-së.

Në legjislacionin shqiptar, të drejtat e të huajve janë sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ku në nenin 16, pika 5 të saj, thuhet shprehimisht se: *“Të drejtat e liritë themelore si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara”*.

Republika e Shqipërisë aderon në konventën *“Për statusin e refugjatëve”*, nënshkruar në Gjenevë, më 28.7.1951, dhe në protokollin *“Për statusin e refugjatëve”*, nënshkruar në Neë York, më 31.1.1967. Ndërsa, në Konventën e OKB-së Shqipëria ka aderuar me anë të dekretit të Presidentit të Republikës nr.200, datë 3.6.1992.

Më pas, Shqipëria ka nënshkruar dhe miratuar edhe marrëveshjen, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, nëpërmjet ligjit nr.7833, datë 22.6.1994, të shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës me nr.878, datë 6.7.1994. Nëpërmjet këtyre akteve, Shqipëria është radhitur në krah të atyre vendeve juridikisht të qytetëruara, duke promovuar dhe përhapur vlerat e njerëzimit dhe duke u bërë pjesë e konventave ndërkombëtare, si për shembull Konventa e Gjenevës së vitit 1951 dhe Protokollin e Neë York-ut në fushën e azilit, duke krijuar një sistem efektiv të azilit, të fushës të të drejtave dhe të detyrimeve për azilkërkuesit, refugjatët, personat në mbrojtje dhe autoritetet përgjegjëse.

Progres Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2021 për Shqipërinë, specifikon: Në lidhje me emigrimin, kuadri ligjor për emigrimin respekton dukshëm *acquis-në e BE - së, por duhet të përditësohet në përputhje me zhvillimet e kohëve të fundit*. Në shkurt 2021, Shqipëria miratoi një ligj të ri për azilin. Në vitin 2020 u miratuan strategjitë për një menaxhim të integruar të kufijve dhe për diasporën. Zbatimi i një strategjie kombëtare për emigrimin dhe plani veprimi për periudhën 2019-2022, përcakton një kuadër të qartë për menaxhimin dhe koordinimin e emigracionit. Ndërsa Komisioni ka lëshuar katër raporte monitorimi. Pavarësisht mbylljes së kufijve gjatë periudhës mars-maj 2020, Shqipëria vijoi të kishte një fluks në rritje me emigrantë të paligjshëm, kryesisht nga Greqia, të cilët largohen nga Shqipëria në pak ditë

për të shkuar në vende të BE-së. Numri i emigrantëve të paligjshëm të kapur në Shqipëri në vitin 2020 u rrit me 13% krahasuar me vitin 2019.²

Ndërsa, për vitin 2022 konkretisht për periudhën Janar - Prill kanë hyrë nga pika e kalimit të kufirit në Kakavijë, Gjirokastër, gjithsej 911 migrantë të parregullt, nga të cilët 61 gra, 6 fëmijë dhe të tjerët burra, të cilët më tej janë trajtuar në qendrat sociale të Bashkisë Gjirokastër. Këta imigrantë janë kryesisht nga Pakistani, Bangladeshi, Siria, Algjeria, Maroku, Nepali dhe Afganistani.

Qendra e Përkohshme e Grehotit

Kjo Qendër është ndërtuar në vitin 2017 me financim nga një grant i Fondit të Migrantëve dhe Refugjatëve të marrë përmes Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, në kuadër të projektit "Përmirësimi i kapaciteteve të pritjes dhe aksesit në shërbime për migrantët dhe refugjatët që hyjnë në Shqipëri", zbatuar nga IOM në vitin 2017 me një buxhet total prej 400,000 mijë euro.

Ajo ka në përbërje 15 njësi akomodimi, me një kapacitet pritës për 60 emigrantë të përkohshëm, që mund të vijnë nga kufiri me Greqinë, një mjedis për kryerjen e intervistave të përzgjedhjes, një mjedis për ngrënien e ushqimit, mjedisi për kryerjen e vizitave mjeksore nga mjeku, si dhe një mjedis të veçantë për fëmijët.

Njësitë për akomodimin, kanë një kapacitet për 4 persona në dhomë dhe janë të kompletuara me nga 2 krevatë (marinari) për fjetje, të pajisura me dyshekë, batanije dhe jastek, si dhe tavolinë për ngrënie e stola për qëndrimin ulur. Çdo dhomë ka kondicioner për ngrohje dhe ftohje. Në rastet kur në këto njësi, akomodohen familje mbi katër persona, kushtet në këto dhoma vështirësohen, por në çdo rast kjo bëhej me pëlqimin e vetë migrantëve.

Mjedisi për kryerjen e intervistave të përzgjedhjes të migrantëve ishte në një kontenier më vete. Ai kishte dy ndarje, në njërin anë punonin punonjësit e policisë kufitare sipas procedurave të parashikuara në ligjin për përzgjedhjen

² https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2021-10/albania_report_2021.pdf

e migrantëve, ndërsa në anën tjetër punonte ekipi i ekspertëve të FRONTEX-it (në përbërje të të cilit ishte dhe një oficer i policisë nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin), të cilët bashkëpunonin me njëri-tjetrin gjatë gjithë procesit deri në momentin e vendimarrjes për secilin prej tyre. Mjedisi për ngrënien e ushqimit, ishte i kompletuar me tavolina, karrige, lavaman me çezëm, si dhe pajisje për ngrohjen e ushqimit. Ushqimi përgatitej dhe servirej nga CARITAS, për tre vakte.

Në këtë qëndër, ndodhet një mjedis i veçantë për kryerjen e vizitave mjeksore. Mjeku ishte siguruar nga CARITAS nga radhët e mjekëve të Spitalit Rajonal Gjirokastrë dhe punonte me kontratë, në varësi të flukseve migratore në pikën e kalimit të kufirit Kakavijë. Dhoma ishte e kompletuar me krevat, tavolinë pune, karrige, pajisje mjeksore ambulatorie të nevojshme për dhënien e ndihmës së shpejtë, ndërsa për rastet e përkeqësuar shëndetësore, ata shoqëroheshin për në Spitalin Rajonal të Gjirokastrës. Në këtë dhomë, ndodhej edhe një raft për mbajtjen e ilaçeve të emergjencës, të cilat nga verifikimi i grupit të inspektimit ishin brenda afatit të skadencës. Mjeku mbante një regjistër ku evidentonte të gjitha rastet e vizitave mjeksore, diagnozat dhe kurën me ilaçe për secilin prej tyre.

Qendra kishte dhe një dhomë të vogël, që përdorej si ambient për fëmijët dhe ishte e kompletuar me tavolina e karrige të vogla, si dhe lodra me qëllim për të kaluar kohën, por kryesorja për të ulur nivelin e lartë të lodhjes, ankthit, traumave dhe stresit të rënduar psikologjik, të shkaktuar nga udhëtimet e gjata në këmbë.

Qendra kishte gjithashtu edhe dy blloqe sanitare, të veçantë për burrat dhe për gratë. Të gjitha njësitë ishin të pajisura me rubineta me ujë të rrjedhshëm, nyje hidrosanitare dhe hidrantë zjarri.

Godina Grupin Operacional Special (GOS) Kakavijë

Kjo pikë e kalimit të kufirit, është një godinë e amortizuar me mjedise të patrajtuara nga ana urbane dhe me nevoja funksionale. Godina aksesohet me vështirësi nga mjetet e transportit për shkak të gjendjes së segmentit rrugor, ndërsa kushtet e brendshme dhe ndriçimi ishin përmirësuar së fundi nga një investim i IOM-it që ishte kryer në godinën e GOS Kakavijë.

Për të lidhur segmentin nga pika kufitare Kakavijë drejt GOS, shërben një tunel i ndërtuar në periudhën para viteve 1990, i cili është i pandriçuar. Kjo e bën të vështirë trajtimin e rasteve të transferimit në këmbë të migrantëve për në godinën e GOS Kakavijë, sidomos gjatë natës. Pika e GOS ne Kakavijë ka përmirësime në mjediset e brendshme të saj, por mjedisi i jashtëm është tërësisht i lënë pas dore.

Nga një vlerësim i UNHCR-së të kryer në vitin 2018, është referuar se kjo godinë ka nevojë për një investim në vlerë rreth 50 mijë dollarë për të kryer rehabilitimin e saj, ripërcaktimin e mjediseve të intervistimit, vënien në funksion të disa mjediseve të braktisura dhe harmonizimin e të gjitha nevojave.

Me qëllim përmirësimit të kapaciteteve në GOS Kakavijë, për të përballuar flukset në rritje migratore në pikën e kalimit të kufirit, në vitin 2020 ishin vendosur në Stacionin Policor të Kakavijës në GOS, 3(tre) kontenierë me njësi akomodimi dhe pajisje sanitare, të instaluar për kapacitetin e mbajtjes deri në 18 persona.

Grupi i inspektimit, u informua gjithashtu se në datë 18-21 Maj 2021 në GOS Kakavijë, u krye një mision i përbashkët i UNHCR-së dhe Ministrisë së Brendshme, përfshirë dhe partnerët nga “Caritas”, me prezencën edhe të ekspertit të jashtëm të Avokatit të Popullit. Në këtë takim janë vlerësuar mendimet lidhur me përmirësimet në infrastrukture, të cilat do të rrisnin standardin e trajtimit të të huajve të parregullt dhe që janë të domosdoshme të kryhen në një periudhë afatshkurtër.

Gjithashtu, në pikat e hyrjes dhe Qendrat për Regjistrimin dhe Akomodimin e Përkohshëm për Migrantët në Grehot dhe Kakavijë, ndodheshin edhe dy ambulanca mjekësore dhe pavione izolimi, të pajisura plotësisht me mjetet e duhura.

Në zbatim të protokollit shëndetësor për parandalimin e COVID-19, në stacionet e Grehotit dhe të Kakavijës ishin instaluar pajisje të dedikuara për larjen e duarve, si dhe ishin vendosur tabela informative dixhitale specifike

me informacione mbi masat anti COVID-19, në gjuhë të huaja në dispozicion për migrantët gjatë qëndrimit në mjediset e Qendrave.

Ky është një investim i kryer nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), në kuadër të projektit “Trajtimi i Sfidave të Covid -19, për Migrantët dhe Refugjatet në Ballkanin Perëndimor”, i financuar nga Bashkimi Evropian.

Një nga problematikat e evidentuara, në kuadër të situatës emergjente të pandemisë, ka të bëjë me faktin se, në këtë qendër **nuk** kryhet asnjë lloj ekzaminimi shëndetësor dhe epideomiologjik i migrantëve në momentin e hyrjes në pikat e kalimit të kufirit ndaj COVID-19, qoftë edhe përmes kryrjes së testeve të shpejta. Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, kjo është një masë e detyrueshme që duhet të ndërmerret nga strukturat shëndetësore vendore në Gjirokastrë, jo vetëm për mbrojtjen dhe sigurinë e shëndetit të migrantëve, por dhe të punonjësve të policisë kufitare në pikën e kalimit të kufirit dhe të popullatës.

Nga monitorimi i vazhdueshëm që institucioni i Avokatit të Popullit kryen në terren, nëpërmjet ekspertit të jashtëm në pikën kufitare të Kakavijës që prej vitit 2018, si rezultat i marrëveshjes mes Avokatit të Popullit dhe UNHCR-së, konstatohet se stafet mbështetëse dhe investimet në qendrat e pritjes së migrantëve të parregullt, janë kryer nga donatorë dhe partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë dhe asnjë prej tyre nuk është kryer me fondet e buxhetit të shtetit shqiptar. Ende vijon edhe këtë vit mungesë e investimeve nga ana e buxhetit të shtetit për këtë pikë kufitare.

Vëmendja e institucionit të Avokatit të Popullit është dhe do të jetë e fokusuar në respektimin e të drejtave të migrantëve të parregullt, që hyjnë në territorin shqiptar, në kuadër të dispozitave ligjore, por dhe konventave ndërkombëtare të ndryshme, që Shqipëria aderon dhe ka ratifikuar në këtë fushë.

Ambientet e intervistimit, ndihma juridike dhe psikologjike

Pasi konstatohen nga rojet kufitare, migrantët e parregullt i nënshtrohen një procedure trajtimi, të përafuar me ato të vendeve të BE-së. Procedura është e bazuar në Udhëzimin e Ministrisë të Brendshme nr.293, datë 04.06.2015 “Mbi trajtimin e të huajve me qëndrim të parregullt në RSH” dhe në

procedurën standarde “Për përzgjedhjen e të huajve të parregullt”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nr.172 , datë 08.02.2018³, ata kategorizohen me statusin si më poshtë:

1. **Azilkërkues** - Kjo kategori dërgohet në Qendrën Kombëtare të Azilkërkuesve në Babrru. Gjatë vitit 2021 numri i personave të referuar në këtë qendër u ul ndjeshëm, për shkak se gjatë kësaj periudhe nuk ka patur asnjë kërkesë për azil, që më tej të referohet për në Qendrën e Babrrusë.
2. **Viktimë trafikimi apo viktimë e mundshme trafikimi** - Kjo kategori i referohet menjëherë strukturave antitrafik të Policisë së Qarkut Gjirokastrë. Gjatë vitit 2021 nuk është evidentuar në territorin e Gjirokastrës ndonjë rast i tillë.
3. **Migrant i parregullt** –në rastet kur nga procedura e përzgjedhjes dhe intervistimit të migrantëve, konstatohet se qëllimi i tyre është kalimi i tyre për në një nga vendet e BE-së, ndaj tyre merret urdhër largimi apo dëbimi nga territori i RSH, ndërsa në raste të shkeljeve ligjore ata ndalohen në Qendrën e Mbyllur për të Huajit në Karreç, Durrës.
4. **Fëmijë të pashoqëruar** - Kjo kategori identifikohet dhe intervistohet në prani të punonjësit të Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijës së Bashkisë Gjirokastrë, që përfshin territorin ku është identifikuar fëmija i pashoqëruar. Të gjitha rastet e trajtuara në Gjirokastrë janë ndjekur na bashkëpunim me Njësine e Mbrojtjes së Fëmijëve pranë Bashkisë Gjirokastrë, ndërkohë që familjet, gratë apo fëmijët e tyre kanë qëndruar në Qendrën Sociale të Bashkisë deri në kryerjen e procedurave. Trajtimi i rasteve është bërë sipas VKM nr.111, datë 06.03.2019 “Për procedurat e riatdhesimit të fëmijës”.

Punonjësit e policisë kufitare të Drejtorisë Rajonale të Kufirit Gjirokastrë kryejnë procedurën e përzgjedhjes (screening process), në varësi të flukseve migratore në mjedisin e intervistimit që ndodhet në ndërtesën e GOS Kakavijë, apo në Qendrën e Përkohshme Grehot. Po ashtu, edhe në rastet e migrantëve të parregullt që evidentohen në Përmet (zonën kufitare të Tri Urave), ata trajtohen pranë Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit Gjirokastrë dhe kryesisht në Qendrën e pritjes së migrantëve në Grehot.

³ Ndryshuar me Udhezimin nr.174, dt.12.09.2022

Në GOS Kakavijë, ambienti nuk ka facilitete hyrjeje nga njëra anë dhe dalje nga një anë tjetër, të personave që intervistohen dhe kjo krijon konfuzion dhe pamundëson përpunimin e shpejtë të të dhënave të grupeve të migrantëve me shumë persona, në raste të ardhjeve masive të cilat nuk kanë munguar dhe varjoinë nga 25-100 persona njëherësh. Ambienti i krijuar në Grehot i plotëson kushtet për kryerjen nga punonjësi i policisë së kufirit të procedurave për identifikimin, intervistimin dhe përzgjedhjen e migrantëve.

Në të dyja qendrat e pritjes së migrantëve në GOS Kakavijë dhe Grehot, ishin të pranishëm dhe asistonin me ndihmesën e tyre punonjësit e policisë kufitare gjatë intervistave që ata zhvillonin me migrantët, edhe ekspertët e FRONTEX-it.

Nga intervistat e zhvilluara me punonjësit e policisë kufitare, është problematikë se për disa gjuhë specifike si Dari, Fars, etj., nuk ka përkthyes të licencuar, çka e vështirëson komunikimin mes tyre gjatë procedurës së përzgjedhjes. Sipas tyre, në këto raste komunikimi bëhet në gjuhën angleze, aq sa mund të jetë e mundur ose në një gjuhë të përafërt me gjuhën e tyre.

Në procedurën e përzgjedhjes krahas punonjësve të policisë të kufirit, migrantët asistohen dhe nga përkthyesit, të cilët sigurohen nga CARITAS. Avokati i Popullit nëpërmjet ekspertëve të saj, vijon të monitorojë grupet e përbashkëta të policisë kufitare dhe të FRONTEX, gjatë pritjes, intervistimit dhe procedurave të përzgjedhjes të migrantëve të parregullt, në zbatimin e standardeve më të mira që garantojnë respektimin e të drejtave të tyre, sipas dispozitave ligjore dhe akteve ndërkombëtare të përmendura më lart.

Autoriteti përgjegjës në kufi dhe në territor për trajtimin e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare dhe për pajisjen me leje qëndrimi është struktura përgjegjëse për kufirin dhe migracionin, sipas ligjit për të huajt.

Ky autoritet gjendet përballë normave ndërkombëtare edhe për sa i përket aspekteve procedurale që shoqërojnë procesin e largimit nga territori i RSH, të cilat janë më rigorozë se ato mbi pranimin. Sidoqoftë, edhe këto kufizime janë modeste pasi i lënë diskrecion të gjerë shteteve në këtë drejtim. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike në nenin 13 të saj parashikon se: “ Një i huaj që jeton në mënyrë të rregullt në një territor, mund të dëbohet që prej aty vetëm në përputhje me ligjin dhe përveç rasteve

kur interesat e larta të sigurisë publike e kërkojnë ndryshe, do t'i jepet mundësia të parashtojë argumentat kundër dëbimit si edhe akses për ta çuar çështjen përpara një autoriteti, një personi apo grupi personash të caktuar posaçërisht për këtë punë nga autoriteti kompetent.”

Migracioni ndërkombëtar është një komponent i rëndësishëm, i cili ka një impakt në ndryshimin e numrit të popullsisë në vendet pritëse. Momentalisht konstatohet se nuk ka ndonjë politikë të veçantë për përmirësimin e imazhit të migrantëve nga vendet pritëse, siç është edhe Shqipëria.

Në analizë të numrit të përgjithshëm vit pas viti të migrantëve që kanë hyrë në territorin e RSH në mënyrë të parregullt, fenomeni që vihet re dhe duhet evidentuar është pikërisht numri i lartë i “kthimeve” të tyre në kufi dhe shumë pak deri pothuajse fare numri i personave që kërkojnë azil apo u jepet mundësia e qëndrimit në Shqipëri.

Në përfundim, sipas informacionit të drejtuesve të DRKM Gjirokastrë, nënshkrimi i një protokollit dypalësh ripranimi me Greqinë, me gjithë kërkesat e vazhdueshme të palës shqiptare, ende nuk është realizuar. Kjo do të bënte të mundur kthimin e migrantëve të parregullt në Greqi sipas protokollit të nënshkruar, por edhe mbi bazën e provave dhe dokumenteve të lëshuara nga pala e kërkuar dhe dakortësia mes dy shteteve.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe ku parashikohet midis të tjerash se: “1. Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar, në vijim mekanizmi kombëtar, i krijuar në përputhje me legjislacionin për Avokatin e Popullit, mbikëqyr zbatimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.

2. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të

përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”;

REKOMANDOJMË:

1. Trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë kufitare, për njohjen me aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin në fushën e migracionit, për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të migrantëve që hyjnë në territorin e RSH në mënyrë të parregullt, si dhe kryerjen e plotë të procedurave ligjore të intervistimit dhe të përzgjedhjes së migrantëve, me qëllim rritjen e numrit të kërkesave për azil në raport me numrin e lartë të kthimeve dhe dëbimeve nga territori i RSH.
2. Ngritjen e mekanizmave që garantojnë informimin e migrantëve në kufi dhe në territor me të drejtat e tyre, si dhe rritjen e transparencës të autoriteteve përgjegjëse për azilin dhe refugjatët, gjatë procesit të aplikimit të kërkesave për azil deri në miratimin apo refuzimin e tyre.
3. Të mundësohet nënshkrimi i një protokollit dypalësh ripranimi me Greqinë, për të bërë të mundur kthimin e migrantëve të parregullt që hyjnë nga kufiri me Greqinë, sipas provave, dokumenteve dhe procedurave të dakortësuara mes të dy shteteve.
4. Në periudha kur ka flukse migratore në kufi, policia kufitare në bashkëpunim me donatorët duhet të marrin masa për të shtuar stafet e punonjësve të policisë dhe ato ndihmëse.
5. Hartimin dhe zbatimin e një projekti rehabilitues për mjediset e GOS Kakavijë, të harmonizuara me nevojat funksionale dhe mundësitë që kanë mjediset egzistuese.
6. Marrjen e masave për ndriçimin e tunelit që përshkon rrugën nga Pika kufitare për në GOS Kakavijë, krijimin e një sistemi për ngrohje/ftohje sipas periudhave të stinës dhe përmirësimin e segmentit rrugor nga Pika doganore tek GOS Kakavijë.
7. Marrjen e masave për një vlerësim teknik nga specialistët e ndërtimit të godinës në GOS Kakavijë e cila ka çarje tektonike, por edhe probleme me bazamentin e saj.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ahmet PREMÇI